



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 27/1 datë 26/04/2004.

**Për miratimin e programit tematik të problemeve që do të
shqyrtojë Këshilli Bashkiak i Tiranës për periudhën
maj 2004 – tetor 2006**

Mbështetur në nenin 32 të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” si dhe në Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Bashkisë, Tiranë,

V E N D O S I

1. Të miratojë programin tematik të problemeve që do të shqyrtojë Këshilli Bashkiak i Tiranës për periudhën maj 2004 – tetor 2006, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Kryesia e Këshillit të marrë masa për zbatimin e këtij programi duke e detajuar në periudha tre – mujore dhe mujore.
3. Kryetari i Bashkisë të marrë masa për zbatimin e detyrave që dalin nga ky vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Luan SHAOLLARI